

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

” Blerje kamion vetshkarkues ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34134200-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

4.083.334 (katër milion e tetëdhjet e tre mijë e treqind e tridhjet e katër) lekë pa tvsh

Vlera e fondit limit është përllogaritur bazuar në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,Kreu VI “rregulla të përgjithshme dhe përgatitja e procesit të prokurimit”,neni 34 “Përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”,Vendimit nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 12 “Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës”.Kjo vlere është llogaritur nga komisioni për llogaritjen e fondit limit të ngritur nga Titullari i AK me urdher nr.217 date 26.04.2024 ,duke u bazuar në studimin etregut dhe duke nxjerre mesataren e tre ofertave nga tre operatore ekonomike që operojnë në këtë fushë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Maliq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Specifikimi i Materialeve:

- | | |
|-----------------------------------|----------------------------------|
| 1. Kategori | Kamion |
| 2. Kilometrat e pershkuar | Jo më shumë se 400,000 km |
| 3. Kapaciteti mbajtës i ngarkesës | Jo më pak se 12 m ³ |
| 4. Fuqia Motorike | Jo më pak se 300 KË |
| 5. Lloji i karburantit | Naftë |
| 6. Transmetim | Transmetim manual |
| 7. Klasa e emetimeve | Jo më pak se Euro 3 |
| 8. Viti i prodhimit | Të jetë i vitit Viti 2001 e lart |
| 9. Peshë maksimale e lejuar | Jo më pak se 25,000 kg |
| 10. Numuri i akseve | 3 akse |
| 11. Numuri i akseve aktivë | 2 akse aktivë (6x4) |

- | | |
|------------------------------------|--------------------|
| 12. Sistemi hidraulik i karocerisë | Hidraulikë me anim |
| 13. Gjerësia | 2550 mm |
| 14. Lartësia | 3300 mm |
15. Mjeti duhet të ketë sistemin e ajrimit të kondicionuar.
 16. Hapja e kazanit nga të treja anët dhe ngritja e kazanit nga të treja anët me hidulik.
 17. Përmasat e gomave R 22.5-13 dhe gomat të jenë të reja.
 18. Me dy dalje hidraulike mbrapa për lidhjen me rimorkiator.
 19. Sistemi elektrik i mjetit të jetë funksional.
 20. Sistemi hidraulik i mjetit të jetë funksional.
 21. Xhamat e mjetit të mos jenë të dëmtuar.
 22. Mjeti nuk duhet të ketë dëmtime të strukturave metalike, apo prezencë të ndryshkut në pjesët e tij.
 23. Sistemi i drejtimit të jetë funksional.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

2.2.2.Operatorë tekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare, 2021 2022 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të

miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, për vitin 2023 ,pranë njësite të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar dhe për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga shpallja e njoftimit të kontratës ,ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% i fondit limit të kesaj kontrate

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin përmbledhës të vetdeklarimit ku mjeti duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin e mëposhtem:

- Certifikatë pronësie,
- Lejë qarkullimi e vlefshme
- Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
- Polica e sigurimit e vlefshme
- Taksa vjetore e mjeteve e vlefshme

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më sipër.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë 1 deklaratë garancie në formularin e vetdeklarimit për një periudhë 1 vjeçare, lidhur për defektet të paparashikuara të mjetit në të cilën do të jenë të përcaktuara qartë të gjitha kushtet e garancise teknike të mjetit.

2.3.4 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin një deklaratë me shkrim me anë të së cilës marrin përsipër të kryejnë shërbimin e transportit të mallit objekt prokurimi brenda afatit dhe sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në formularin e njoftimit të kontratës.

Kerkesat e përcaktuara në pikat 2.3.2 2.3.3 2.3.4 janë vendosur bazuar në Nenin 40 pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” janë vendosur për të provuar se operatori ekonomik është në kushtet për të sjellë mjetin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, sipas afatit të përcaktuar dhe mjeti të kete dokumentacionin e nevojshem shoqerues.

Duke qene se kerkohet mjet operatori ekonomik duhet te mbaje garanci per nje periudhe nje vjecare per defektet e mundshme qe mund shfaqë mjeti.